

STATUTI

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "MAKINA E LUMTUR"

Përkufizime

Në këtë statut temat :

- "Ligji" → është ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- "Statut" → është statuti "MAKINA E LUMTUR" shpk
- "Ditë të plota" → në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më datë 28.01.2022 unë themeluesi kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "MAKINA E LUMTUR"
2. Themeluesi i shoqërisë është :
 - ▶ Emër, Mbiemër : Ahmed Kalaja
 - ▶ Forma e shoqërisë : Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
 - ▶ Emri ligjor i shoqërisë : MAKINA E LUMTUR
 - ▶ Adresa e shoqërisë : Rruga "Loni Ligori", pallati Romario, kati nentoke, bodrum, Tiranë
 - ▶ Vendi regjistrimit : TIRANË

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm : Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj : Për një periudhë kohore të pakufizuar.

Neni 4

Selia, Adresa e faqes së internetit dhe adresa elektronike

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : "Loni Ligori", pallati Romario, kati nentoke, bodrum, Tiranë

KREU II

KAPITALI I RREGJISTRUAR

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit të rregjistruar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është : 1.500.000 lekë

Ortaku zotëron 1 (një) kuotë

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm :

▶ Ortaku themelues :	<u>Ahmed Kaiaja</u>
▶ Lloji i kontributit :	<u>LEKË</u>
▶ Vlera e kontributit :	<u>1.500.000 lekë</u>
▶ Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë :	<u>100 %</u>

Vlera totale e kapitalit të rregjistruar është : 1.500.000 lekë

Vlera e paguar është : 1.500.000 lekë

2. Kapitali themeltar i shoqërisë është rregjistruar : QKB

Neni 6

Llojet e kuotave, të drejtave dhe kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Ortakut të Vetëm.

Neni 7

Kalimi i kuotave me trashëgimi ose si pasojë e falimentimit

1. Nëse Ortaku i Vetëm vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët e tij do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij, pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e Ortakut të Vetëm të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh një person tjetër të rregjistrohet si zotëruar i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
3. Personi tjetër që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruar i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës, deri në momentin e rregjistrimit në QKB.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Shoqëria me vendim të Ortakut të Vetëm mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet edhe me qëllim, pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.
2. Shoqëria me vendim të Ortakut të Vetëm mund të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 9

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- ▶ miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ▶ shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- ▶ investime;
- ▶ vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 10

Emërimi i administratorit

Shpk "MAKINA E LUMTUR" ka si administrator të saj, z. Ahmed Kalaja.

Në pajtim me ligjin, neni 95, pëika 1, afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Emër, mbiemër	Adresa	Specimenti i nënshkrimit
	Rruga "Loni Ligor", pallati Romano, kati nentoke, bodrum, Tiranë	

Neni 11

Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- ▶ kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- ▶ përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- ▶ kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- ▶ përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me përdorimin e fitimeve;
- ▶ krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- ▶ kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT" ndryshuar me ligjin Nr. 131/2015 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT";
- ▶ kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

KREU IV

DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 12

Dividentët

1. Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria mund të deklarojë shpërndarjen e dividendit.
2. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë, nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Neni 13

Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar

Administratori pas vendimit të marrë nga Ortaku i Vetëm dhe referuar përcaktimeve të nenit 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara, të cilët nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë, apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Neni 14

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjatimisht, viti i parë financiarë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

KREU V PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 15

Prishja dhe shpërndarja

Prishja dhe shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar, siç mund të jenë :

- ▶ Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhimit të veprimtarisë së saj.
- ▶ Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji Nr.8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin".
- ▶ Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Neni 16

Likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim për emërimin e 1 ose disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës, duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrit të Shoqërive.

Likuiduesi, në përputhje me ligjin dhe me vendimin e Ortakut të Vetëm, mund të shpërndajë në dobi të ortakut të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri.

Neni 17

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

Ky statut u përpilua në (tre) 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, të miratuar në parim dhe nen për nen dhe nënshkruar në të gjitha kopjet, duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën e tyre origjinale.

ORTAKU I VETËM

Ahmed Koley

